

UDHËZIM

Nr. 10693/2, datë 1.7.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË
VEÇANTA DHE ADMINISTRIMIN E
TYRE NGA AUTORITETET
DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 102, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", si dhe të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

1. Shërbimet e veçanta dhe tarifavat (pagesat) për këto shërbime, jepen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Autoriteti përgjegjës për mbledhjen e tarifave sipas niveleve të përcaktuara në aneksin 1, është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore.

3. Të ardhurat nga tarifavat e mbledhura, derdhen 100% (njëqind për qind) në buxhetin e shtetit.

4. Pagesa e tarifës kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij.

5. Mënyrat dhe procedurat e arkëtimit të tarifës përcaktohen në aneksin 2, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Tarifavat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

7. Autoriteti doganor ka të drejtën të mos çlirojë mjetin apo mallin për të garantuar tarifën që duhet paguar për shërbimin e marrë.

8. Aktet e nxjerra nga autoritetet doganore për caktimin e tarifave për shërbimet e veçanta të ofruara nga autoritetet doganore shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**

ANEKSI 1

TARIFAT PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË VEÇANTA

Nr.	Kodi	Klasifikimi i të ardhurës dytësore	Tarifa e shërbimit
1	7111007	Të ardhura nga parkimi në ambientet që administrohen nga autoritetet doganore deri 24 orë:	
		a) Për automjetet	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		i. kamionë, furgonë deri 10 tonë	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		ii. kamionët mbi 10 tonë	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		b) Për autovetura dhe mikrobusë	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
		i. autovetura dhe mikrobusë 8+1 ii. autovetura dhe mikrobusë mbi 8+1	700 lekë (60 minutat e para pa pagese)
Shënim. - Nuk ka tarifë shërbimi për parkimin e mjeteve të sipërcituara për kohëzgjatjen deri në 60 minuta. - Nuk ka tarifë shërbimi për parkimin e mjeteve të transportit, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor.			
2	7113006	Të ardhura nga shtypshkrimet/plumbçe doganore:	
		a) Tarifavat e furnizimit ndaj të tretëve me shtypshkrime	
		i. Certifikatë e origjinës preferenciale të mallrave (EUR1/FORMA A/EUR- MED) ii. Approval Certificate TIR	Pa pagesë Pa pagesë
		b) Tarifavat e furnizimit ndaj të tretëve me plumbçe doganore	50 lekë
3	7111099	Të ardhura për mallrat e të tretëve që magazinohen në magazinat që administrohen nga autoritetet doganore deri 24 orë:	
		a) Për mallrat deri 500 kg ose sipërfaqe deri 2 m ²	500 lekë

		b) Për mallrat mbi 500 kg - 1000 kg ose sipërfaqe mbi 2m ² deri 10 m ²	1000 lekë
		c) Për mallrat mbi 1000 kg - 2000 kg ose sipërfaqe mbi 10 m ² deri 20 m ²	1500 lekë
		ç) Për mallrat mbi 2000 kg - 3000 kg dhe sipërfaqe mbi 20 m ² deri 30 m ²	2000 lekë
		d) Për mallrat mbi 3000 kg ose sipërfaqe mbi 30 m ²	2500 lekë
Shënim. Nuk ka tarifë shërbimi për mallrat që magazinohen, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor.			
4	7111099	Tarifa për shërbimet ndaj operatorit ekonomik që kërkon praninë e personelit doganor në ambiente të tjera nga ato doganore (magazina të përkohshme, magazina doganore etj.) ose jashtë orarit zyrtar të punës:	
		a) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C1 është	800 lekë
		b) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C2 është	700 lekë
		c) Një orë pune e një punonjësi të kategorisë C3 është	500 lekë
Tek kjo tarifë duhet të merren në konsideratë përcaktimet, si vijon: - Mjeti i transportit në të gjitha rastet do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik kërkues; - Koha e transportit do të përllogaritet si kohë pune; - Shtesa e pagesës për orët e punës, pas orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit zyrtar llogaritet sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit për nëpunësit civil.			
5	7111025	Tarifa e shërbimit për peshimin e mjeteve të transportit:	
		a) Për kamionët, furgonët deri 10 tonë	700 lekë
		b) Për kamionët mbi 10 tonë	1000 lekë
Te kjo tarifë duhet të merren në konsideratë përcaktimet, si vijon: - Përzgjedhja e mjeteve të transportit për peshim bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.			
6	7113099	Tarifa e shërbimit për ngarkim-shkarkimin e kamionëve për kontroll të plotë fizik:	5000 lekë për mjet
7		Tarifa e parkimit për mjetet e transportit, në rastet kur ato bllokohen në zbatim të një vendimi të nxjerrë nga organ shtetëror/organ gjyqësor	Pa pagese

ANEKSI 2 MËNYRAT DHE PROCEDURAT E ARKËTIMIT TË TARIFAVE

1. Pagesa e tarifës së shërbimit ndaj të tretëve për parkimin e mjeteve apo magazinimin e mallrave, sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe 3, të aneksit 1, kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij, para daljes të mjetit nga parkimi apo para daljes së mallrave nga magazina.

Zyra e financës në degë doganore, i vë në dispozicion “Faturën për arkëtim”, sipas udhëzimit nr. 19 datë 20.5.2010 “Për përdorimin e faturës për arkëtim” të ministrit të Financave (formati bashkëlidhur aneksi 3) punonjësit doganor përgjegjës për parkimin/magazinën.

Punonjësi doganor përgjegjës për parkimin/magazinën, plotëson “Faturën për arkëtim” në tri kopje dhe ia jep marrësit të shërbimit ose përfaqësuesit të tij. Në “Faturën për arkëtim” duhet të referohen të dhënat në përputhje me Regjistrin e Magazinimit të Përkohshëm të plotësuar bazuar në udhëzimin e DPD “Mbi zbatimin e procedurave të magazinimit të përkohshëm të mallrave”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogarinë e Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen punonjësit doganor përgjegjës për parkimin/magazinën në

mënyrë që të bëhet i mundur çlirimi i mjetit apo mallit.

Në fund të ditës punonjësi doganor përgjegjës për parkimin/magazinën dorëzon të gjitha “Faturat për arkëtim” në zyrën e financës në degë doganore.

“Faturat për arkëtim” kontabilizohen nga zyra e financës në degë doganore, në një regjistër të

veçantë sipas formularit A si më poshtë. Zyra e financës është përgjegjëse për rakordimin një herë në javë të regjistrit, sipas formularit A, si më poshtë, me të dhënat e regjistruara në Regjistrat e Magazinimit.

FORMULARI A
REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PARKIMIT/MAGAZINIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Data dhe ora e hyrjes në parkim/magazinim	Data dhe ora e daljes nga parkimi/magazinim	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

2. Për plumbçet e përdorura gjatë procedurave, sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të pikës 2, të aneksit 1, pritet mandat arkëtimi sipas udhëzimit të DPD-së “Mbi procedurat e administrimit të plumbçeve” në tri kopje.

Punonjësi doganor i autorizuar për përdorimin e plumbçeve në fund të ditës dorëzon te zyra e financës në degë doganore të gjithë shumat e mbledhura dhe dokumentacionin përkatës. Zyra e financës ditën e nesërme të punës kryen derdhjen e shumës së mbledhur në bankat e nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit.

Zyra e financës në degë doganore duhet të bëjë kontabilizimin dhe inventarizimin e plumbçeve si artikull i veçantë. Rakordimet midis gjendjes kontabël dhe gjendjes fizike duhet të bëhet jo vetëm në sasi por edhe sipas numrave të serive për të gjitha rastet ku aplikohet plumbosje doganore.

3. Pagesa e tarifës për shërbimet ndaj operatorit ekonomik që kërkon praninë e personelit doganor në ambiente të tjera nga ato doganore ose jashtë orarit zyrtar të punës, sipas përcaktimeve të pikës 4, të aneksit 1, kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij.

Operatori ekonomik i interesuar për marrjen e këtij shërbimi, i drejton një kërkesë zyrtare degës së

doganës kompetente. Në rast se kjo kërkesë miratohet, dega e doganës lëshon një urdhër shërbimi ku përcaktohet numri i punonjësve që do të kryejnë shërbimin.

Zyra e financës, mbi bazën e urdhër shërbimit, i vë në dispozicion “Faturën për arkëtim”, punonjësit doganor përgjegjës të shërbimit, i cili në përfundim të shërbimit e plotëson sipas përcaktimeve të pikës 4, të aneksit 1, “Faturën për arkëtim” në tri kopje dhe ia jep marrësit të shërbimit ose përfaqësuesit të tij.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogarinë e Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohet punonjësit doganor përgjegjës për shërbimin.

Në fund të ditës punonjësi doganor përgjegjës për shërbimin dorëzon “Faturën për arkëtim” në zyrën e financës në degë doganore.

“Faturat për arkëtim” kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë sipas Formularit C si më poshtë.

FORMULARI C
REGJISTRI I TARIFËS SË SHËRBIMIT

Nr.	Lloji i shërbimit të ofruar	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Data dhe ora e nisjes së shërbimit	Data dhe ora e përfundimit të shërbimit	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

4. Pagesa e tarifës së shërbimit për peshimin e mjeteve të transportit

Përzgjedhja e mjeteve të transportit për peshim bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Marrësi i shërbimit, sipas kërkesës së tij, tërheq te zyra e financës në degë doganore dokumentin “Faturë për arkëtim”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogari të Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen zyrës së financës në degë doganore.

Shumat e tarifave të arkëtuara kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë, sipas formularit D, si më poshtë.

FORMULARI D
REGJISTRI DËTOR I TARIFËS SË PESHIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/Targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

5. Tarifa e shërbimit për ngarkim-shkarkimin e kamionëve për kontroll të plotë fizik

Përzgjedhja e mjeteve të transportit për kontroll të plotë fizik, bëhet në bazë të analizës së riskut, përcaktuar me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Marrësi i shërbimit, sipas kërkesës së tij, tërheq te zyra e financës në degë doganore dokumentin “Faturë për arkëtim”.

Marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij me këtë dokument kryen pagesën në bankat e nivelit të dytë për llogari të Thesarit.

Një kopje e “Faturës për arkëtim” e vulosur nga banka dhe një kopje e dokumentit që lëshon vetë banka për veprimin e kryer i dorëzohen zyrës së financës në degë doganore.

Shumat e tarifës së ngarkim shkarkimit të arkëtuara, kontabilizohen nga zyra e financës në një regjistër të veçantë, sipas formularit E, si më poshtë.

FORMULARI E
REGJISTRI DËTOR I TARIFËS SË SHËRBIMIT TË NGARKIM-SHKARKIMIT

Nr.	Lloji i mjetit/targa	Lloji dhe sasia e mallit	Emri i marrësit të shërbimit ose përfaqësuesi i tij	Nr. dhe data e dokumentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar

ANE
KSI 3
FATURË PËR
ARKËTIM

Nr. _____, datë

Me anë të kësaj fature kërkohet që banka nivelit të dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik/persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë :

Emri i institucionit përfitues

Dega e Doganës _____

Kodi i institucionit

Kodi i degës së Thesarit ku vepron

Emri i paguesit (person/ person fizik/ person juridik)

Numri identifikimit të paguesit

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet lekë
	Emërtimi	kodi i llogarisë ekonomike	
1			
2			
3			
X	TOTALI	X	0

Përfaqësuesi i institucionit juridik) (emër, mbiemër, nënshkrimi)
nënshkrimi)

(person / person fizik / person (emër, mbiemër,